



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:127098
Datë: 18.09.2024
Numri i dokumentit: 06179065

C.nr.2070/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridiko kontestimore të paditësit H.H. me numër personal nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson A.L. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës B.K.S. me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e Sigurimeve “Scardian” nëpërmjet të autorizuarit M.B. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 4,632.70 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor - publik, me datë 04.09.2024, ku prezantuat të autorizuarit e ndërgjyqësve mori, ndërsa përpiloi me shkrim më datë 18.09.2024, këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit H.H. nga Prizreni dhe **DETYROHET** e paditura B.K.S. me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit materia dhe jo material, të shkaktuar në aksidentin e datës 19.05.2022, ti paguaj paditësit H.H. shumat si në vijim, dhe atë:

1) Dëmi jo material:

- a) për dhimbje fizike (trupore), shumën prej..... **1,200.00 €**
b) për frikë, shumën prej**1,200.00 €**

Shuma të cilën është e detyruar e paditura, që t’ia paguaj paditësit, në emër të dëmit jo material të shkaktuar tek paditësi, është **shuma e përgjithshme prej 2,400.00 euro (dymijë e dyqind)**, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit (04.09.2024) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

2) Dëmi material:

- c) në emër të ndihmës së personit të tretë, për 10 ditë, shumën prej.....**150.00 €**
d) në emër të ushqimit të përforcuar, për 18 ditë shumën prej.....**270.00 €**
e) në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumën prej **72.70 €**

Shuma e përgjithshme në emër të dëmit material është në lartësi prej **492.70 euro (katërqind e nëntëdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë cent)**, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (21.06.2022) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit H.H. dhe atë: për a) për dhimbje fizike (trupore) në shumë prej 800.00 euro; b) për frikë në shumën prej 800.00 euro, e) në emër të ndihmës së personit të tretë në shumë prej 50.00 euro; e) në emër të ushqimit të përforcuar në shumë prej 90.00 euro, **refuzohet e pabazuar.**

III. OBLIGOHET e paditura B.K.S. që në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguajë paditësit H.H. shumën **prej 735.40 euro (shtatëqind e tridhjetë e pesë euro e katër dhjete cent)**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi H.H. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij A.L. avokat nga Prishtina, me datën 21.06.2022, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi, të cilën e ka ndryshuar me parashtrësën me shkrim të datës 19.08.2024, ndaj të paditurës B.K.S. me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 7,838.35 euro.

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi H.H. përmes të autorizuarit të tij, në padinë e paraqitur ka theksuar se me datën 19.05.2022, ka ndodhur një aksident i komunikacionit në autostradën “Arbër Xhaferi” komuna e Prizrenit, ka ardhur me fajin ekskluziv të vozitësit D.Lj. i cili duke e drejtuar automjetin e markës “Golf”, me targë ... nga pakujdesia dhe duke mos e respektuar rregullat e komunikacionit rrugor, ishte kyçur në kahen e kundërt të lëvizjes së automjeteve në autostradën “Arbër Xhaferi”, ku e njëjta me pjesën e përparme të anës së majtë godet në pjesën e përparme në anën e majtë automjetin e markës “Audi A6”, me targë ... të cilën ishte duke e drejtuar paditësi H.H. në shiritin e tij të lëvizjes me përparësi kalimi, çka paditësi nga inercioni i goditjes së marr ka goditur edhe anësoret e autostradës, si pasojë e këtij aksident trafiku lëndime trupore ka pësuar H.H. në cilësinë e vozitësit në automjetin e markës “Audi A6”, me targë ...

I autorizuari i paditëses edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa me parashtrësën me shkrim të datës 19.08.2024, e ka bërë ndryshimin e padisë respektivisht zgjerimin e kërkesëpadisë. Në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se nga provat e administruara gjatë këtij procesi është vërtetuar në tërësi baza juridike dhe legjitimiteti i palëve në procedurë nuk është kontestuese, ka shtuar se përmes ekspertizës mjekësore dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës u

vërtetua fakti kontestues lidhur me natyrën e lëndimeve të paditësi dhe pasojat e mbetura nga lëndim fizik dhe dëmtimi psikik. Po ashtu, sipas të autorizuarit të paditësit propozon gjykatës që lidhur me kërkesë padinë që ka të bëjë me të gjitha format e dëmeve materiale dhe jo material të vendos që të detyroj të paditurën të ia paguaj paditësit kompensimin e dëmit siç ka kërkuar në petitumin të parashtrës për precizimin e kërkesë padisë dhe të korrigjuar në këtë seancë së bashku me kamatën ligjore të kërkuar dhe të specifikuar në këtë parashtrës. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovon në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontesti morë i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 735.40 euro, nga shuma e kërkuar prej 885.40 euro me këtë parashtrës të precizimit pasi që shuma prej 150 euro për pagesën e ekspertizës së makinerisë është përfshirë në pajtim gjyqësor.

E paditura përmes përgjigjes në padi të datës 02.03.2023, ka theksuar se nuk e konteston bazën juridike të padisë, por kontestuese mbetet lartësia e kërkesëpadisë me arsyetim se pala paditëse nuk ka ofruar prova të cilat argumentojnë shumën e kërkuar. Tutje ka shtuar se me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit të kësaj procedure palës paditëse është ofruar ofertë për të gjitha kategoritë të demit material dhe jo material në shumën prej 900 euro, si dhe sa i përket demit material në automjetin i është ofruar oferta në shumën prej 2,000.00 euro, por që oferta e ofruar nuk është pranuar nga të njëjtit. Po ashtu sipas të paditurës, jashtë shumës së ofruar e paditura e konteston lartësinë e kërkesëpadisë dhe se barra e provave bie mbi palën paditëse, në shkresat e lëndës nuk posedon ndonjë provë që do të provonte shumën tjetër jashtë shumës së ofruar.

Edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore i autorizuari e të paditurës ka mbetur në tërësi sikurse në përgjigjen në padi. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë pretendimeve të paraqitura gjatë shqyrtimit të këtij objekti kontesti duke e kontestuar edhe më tutje kërkesëpadinë e paditësit për nga lartësia për të gjitha format dhe kategoritë e demit të kërkuar me parashtrës dhe të ri precizuar edhe në seancën e fundit si tejet të larta dhe jo proporcionale me lëndimet që ka pësuar paditësi nga ky aksident dhe se që të gjitha lëndimet i kanë kategorizuar ekspertët mjekësor si lëndime të lehta trupore dhe për këtë arsye duke u bazuar në praktikën e deritashme është ofruar shuma prej 1000 euro për të gjitha format e demit material dhe jo material, që ka pësuar paditësi nga ky aksident. Tutje sipas të autorizuarit të paditurës sa i përket kamatës së kërkuar e kundërshton si të pa bazuar duke u nisur nga fakti dhe qasja e paditurës që lënda të mbyllet në çdo fazë të procedurës, ndërsa sa i përket shpenzimeve i propozon gjykatës që të aprovohen sipas tarifës së Odës së Avokatëve, dhe se propozon gjykatës që me rastin e vendosjes kërkesëpadinë e paditësit të refuzoj, mbi shumën e ofruar nga e paditura, si të pa bazuar.

Në shqyrtimin kryesor të datës 04.09.2019 palët ndërgjyqës kanë arritur pajtim gjyqësor sa i për ketë kërkesës për demin material në veturën “Audi A6” me targa

Provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Ekspertizën nga lëmi e

ortopedisë - traumatologjisë e punuar nga Dr. V.B. e datës 07.06.2024; Ekspertizën nga lëmi e psikiatrisë e punuar nga Dr. Sh.M. e datës 07.06.2024; Raporti i policisë me nr.2022-TR199, i datës 19.05.2022; Kuponët fiskal, të datës 26.05.2022, vlera 8.60 euro, të datës 25.05.2022, vlera 30 euro, të datës 26.05.2022, vlera 11.30 euro, të datës 26.05.2022, vlera 22.80 euro dhe fatura nr.S-163, të datës 04.06.2022, vlera 30 euro.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestim orë (LPK), duke i çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se kërkesëpadia e paditëses **është pjesërisht e bazuar**.

Nga leximi i ekspertizës mjekësore të ortopedisë-traumatologjisë, e punuar nga Dr. V.B. të datës 07.06.2024, e cila është bërë duke u bazuar në dokumentacionet mjekësore të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe ekzaminimin e drejtpërdrejtë të paditësit H.H. gjykata vërtetoi faktin se si pasojë e aksidentit të datës 19.05.2022, këtu paditësi H.H. ka pësuar lëndime të lehta trupore, të cilat paditësi në fjalë i kanë shkaktuar: **dhimbje fizike: - të intensitetit posaçërisht të rëndë - nuk ka pasur, të intensitetit të rëndë – 24 orë**, kohë pas kohe, deri në marrjen e terapisë së kundër dhimbjes, **të intensitetit të mesëm - 18 ditë**, periudha e ramjes së edemës dhe hematomës në regjionet e lënduara të qafës krahut dhe anës së majtë të gjoksit, **të intensitetit të ulët – edhe për 1 muaj. Shëmtim trupor – nuk ka. Ndhimja e personit të tretë – ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 10 ditësh. Ushqim i përforcuar - ka qenë i nevojshëm për 18 ditësh, në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasur me proteina, minerale dhe vitamina. Rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik ka qenë i nevojshëm për 10 ditë për forcimin e muskujve të regjionit të qafës dhe gjoksit pas lëndimit, (më gjerësisht si në ekspertizën e datës 07.06.2024, e cila gjendet në shkresat e lëndës).**

Nga leximi i ekspertizës mjeko ligjore të psikiatrisë nga Dr. Sh.M. e datës 07.06.2024, lidhur me ekzaminimin të paditësit H.H. gjykata ka vërtetuar se paditësi, në aksidentin e datës 19.05.2022, ka pësuar lëndime trupore dhe frikë në një aksident të komunikacionit. Sipas kësaj ekspertize, paditësi ka përjetuar **frikë primare e intensiteti posaçërisht të lartë – disa sekonda**, si reagim intensiv për shkak të perceptimit të rrezikut për goditje nga ana e automjetit tjetër dhe vlerësimi i gjendjes së shëndetit fizik, të manifestuar si rezultat i drejtpërdrejte i rrezikut për humbjen e jetës, **frikë sekondare e intensitetit të lartë në kohëzgjatje 40 minuta, frikë sekondare e intensitetit të mesëm – në kohëzgjatje tri javë dhe frikë sekondare e intensitetit të ulët – dy vite**, e manifestuar në varësi nga dhimbje të cilat kanë mund të fitojnë në intensitet varësisht nga sforcimet fizike, pozita e caktuara trupore, si dhe në ndryshim të motit, (më gjerësisht si në ekspertizën e datës 07.06.2024, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Nga leximi i raportit të policisë me nr.2022-TR1- 99, i datës 19.05.2022, gjykata ka vërtetuar se më datën 19.05.2022, rreth orës 10:30 minuta, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në autostradën “Arbër Xhaferi”, deri tek aksidenti i dyshohet se ka ardhur kur drejtuesi i veturës A, po lëvizte në shiritin për hyrje në autostradë ku trafiku zhvillohej në kahja të kundërt dhe me pjesën e përparme anën e majtë vetuar A godet veturën B në pjesën e

përparme anën e majtë duke e shtyrë që vetura B të godas mbrojtësen metalik anës së djathtë. Nga ky aksident përpos dëmeve materiale në dy vetura, lëndime trupore ka pësuar drejtuesi i veturës B.

Nga leximi i kuponëve fiskal, të datës 26.05.2022, vlera 8.60 euro; të datës 25.05.2022 së bashku me faturën S-16346-2022 vlera 30 euro; të datës 26.05.2022, vlera 11.30 euro; të datës 26.05.2022, vlera 22.80 euro, gjykata ka konstatuar faktin se paditësi H.H. kisha marr medikamente dhe shërbime mjekësore, si pasojë e lëndimeve të marra gjatë aksidentit të përshkruar më lartë në shumën e përgjithshme prej 72.70 euro.

2. Baza Ligjore

Neni 136 i Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve, par.1 të tij përcakton se: “Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”, neni 137 i po këtij ligji përcakton: “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”, neni 140 i këtij ligji përcakton: “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”, ndërsa neni 159 i po këtij ligji përcakton se: “Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar për faj të një poseduesi të automjetit, vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”. Sipas nenit 169, par.1, është përcaktuar se: “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”, par.2. “Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla” dhe par. 3. “Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit”. Neni 174 i këtij ligji përcakton: “Gjykata duke marr parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të demit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues”. Ndërsa neni 179 i këtij ligji përcakton: “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”, kurse neni 183 par.1 i po këtij ligji përcakton: “Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor,..., si dhe frikës etj., gjykata po të konstatoj se rrethanat e rastit e sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i demit material...”, ndërsa par.2 i këtij ligji përcakton: “Me rastin e vendosjes për kërkesën e shpërblimit të demit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të mirës si dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe më qëllimin shoqëror”. Gjithashtu me nenin 323 i LPK-së përcaktohet se “Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet

shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”.

Po ashtu bazuar në nenin 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia (Ligji Nr. 04/L-018), parasheh *“Kompensimi i dëmit material dhe jo material bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve”*. Dhe sipas nenit 9, par.1 nenpar.1.1 *“Sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon: 1.1. dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik”* dhe neni 25 par.1 të ligjit të lartë cekur, i cili parasheh se *“I dëmtuari ka të drejtë që kërkesën për dëmshpërblim nga baza e sigurimit të auto përgjegjësive t’ia parashtrijë drejtpërdrejt siguruesit përgjegjës. Siguruesi është i detyruar që ditën e pranimit ta regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim në librin/evidencën e posaçme të dëmeve sipas radhitjes numerike dhe në afat prej tre (3) ditësh, ta vërtetojë pranimin duke njoftuar palën me referencën e kërkesës së evidentuar”*.

3. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura gjykatës i rezultoi se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë andaj në këtë drejtim gjykata nuk ka nxjerr prova të veçanta. Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se ekziston lidhja shkakësore juridike në mes aksidentit të ndodhur dhe lëndimeve të paditësit të cilin fakt gjykata e vërtetoi nga provat materiale të administruara, andaj edhe të njëjtën e ka aprovuar pjesërisht sikurse është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në lidhje me lartësinë e kërkesave të aprovuara sikurse në shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata konstaton se të njëjtat janë adekuate, e gjithë kjo duke u bazuar në lëndimet e pësuar nga paditësi si pasojë e aksidentit të shkaktuar. Duke u bazuar në ekspertizën e ortopedisë – traumatologjisë të përpiluar nga eksperti ortoped Dr. V.B. gjykata ka vërtetuar faktin se lëndimet e paditësit janë lëndime të lehta trupore. Lëndime këto të cilat paditëses i kishin shkaktuar dhimbje fizike të të gjitha llojeve: të intensitetit të rëndë, të intensitetit të mesëm dhe të intensitetit të ulët. Si pasojë e lëndimeve të marra në aksident paditësi kishte pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë (10 ditë), ushqim të përforcuar prej 18 ditësh dhe. Të gjitha këto lëndime të përshkuara në ekspertizën e ekspertit ortoped Dr. V.B. të cilës gjykata ia fali besimin e plotë.

Është vërtetuar po ashtu se paditësi në aksidentin e ndodhur kishte përjetuar të gjitha llojet e frikës, të cilat janë përshkruar nga eksperti i psikiatrisë Dr. Sh.M. në ekspertizën e tij. Edhe kësaj ekspertize gjykata ia fali besimin e plotë. Ndërgjyqësit nuk kishin vërejtje në ekspertizën e ortopedisë dhe traumatologjisë dhe të psikiatrisë, andaj në rastin konkret mes palëve nuk kemi fakte kontestuese sa i përket këtyre ekspertizave dhe lëndimeve të pësuar nga paditësi dhe frikës së përjetuar nga i njëjti. Andaj, të gjitha këto e kanë bindur gjykatën që të vendos sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, pasi që shumat e aprovuara janë në përputhje të plotë me lëndimet e pësuar nga paditësi.

Gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi ngase konsideroi se shumata e kërkuara mbi shumata e aprovuara si në pikën I të dispozitivit janë të larta dhe nuk i përgjigjen lëndimeve të cilat i ka pësuar paditësi në aksidentin e datës 19.05.2022 dhe të gjitha rrethanave tjera të cilat janë me rëndësi për vlerësimin dhe caktimin e kompensimit. Andaj, gjykata vlerëson se me vlerat të cilat ka aprovuar në emër të dëmit jo material do të arrihej qëllimi i kompensimit të drejtë të dëmit të pësuar me aksidentin në komunikacion. Gjithsesi, gjykata mori për bazë kushtet dhe rrethanat në të cilat është shkaktuar ky aksident, moshën e paditësit si dhe gjendjen ekonomike në Kosovë si dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës nr.41/2023 të datës 27.02.2023.

Gjykata e refuzoi pjesën e kërkesëpadisë së paditësit, që ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur që paditësit në emër të personit të tretë të i' a paguaj shumën prej 50.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 90.00 euro, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i aprovuar pjesërisht kërkesat e të njëjtit pasi që kjo gjykatë i vlerëson si të pranueshme për nga baza, duke marr për bazë kohëzgjatjen e nevojës për perkujdesjen e personit të tretë, ushqimin e përforcuar të konstatuar në ekspertizë mjekësore për paditësin, si dhe nga fakti që praktika gjyqësore i njeh rastet e tilla të kompensimit. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh fakti se për këto forma të dëmit në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo, pasi që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e huaj, ushqim të përforcuar (sikurse në ekspertizë), të njëjtit ligjërisht i takon kompensimi për këtë lloj të dëmit material dhe në shumata e vlerësuara nga ana e gjykatës dhe atë për ndihmën e personit të tretë njohu vlerën prej 15 euro në ditë për 10 ditë në shumë prej 150 euro ndërsa për ushqim të përforcuar vlerën prej 15 euro në ditë për 18 ditë shumën prej 270 euro.

Ndërsa sa i përket dëmit material tjetër i cili rrjedh si pasojë e shërimit të paditësit, pas shkaktimit të aksidentit (blerja e barnave, vizitave mjekësore për shërim), gjykata vendoi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pika 2), nën pika e) dhe atë në shumën prej 72.70 euro, pasi janë të argumentuar me prova konkrete (faturave), të cilave gjykata ia fal besimin e plotë. Nga shkresat e lëndës konstatohet se vlera e faturave të paraqitura nga paditësja arrijnë lartësinë në 72.70 euro, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ekspertët përkatës e kanë vlerësuar se lëndimet e paditësit janë lëndime të cilat karakterizohen si lëndime të karakterit të lehtë trupor. Andaj, edhe lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarit-paditësit, statifaksion që ai të jetë në gjendje të kompensojë të mirat jo materiale dhe materiale nga të cilat është privuar, e kjo duke marr parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve, frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe të gjitha lëndimeve tjera të përshkruara më hollësisht në ekspertizën e ekspertëve përkatës, të cilat i kemi përmendur më lartë, gjykata ka vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar për dëmin jo material dhe material, me kamatë prej 8%, krejt kjo duke u bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, si dhe duke u bazuar në mendimin Juridik të Gjykatës Supreme me nr.265/2020, të datës 02.12.2020, pjesa e tretë pika XIV, Gjykata për dëmin material vendosi që kamatë fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë (datë 21.06.2022), ndërsa kamata për dëmin jo material fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi (datë 04.09.2024) duke u bazuar në mendimin juridik të lartcekur pika XV.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritorë të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Për pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 452 parag.1 lidhur me nenin 463.1 të LPK-së, si dhe në bazë të TA-së, në të cilat janë përfshirë, përpilimi i padisë në shumë prej 104.00 euro, për taksën gjyqësore shumë prej 61.00 euro (pasi që vlera e kontestit me kërkesën për të cilën është arritur pajtim gjyqësor është 7,838.35 euro), për përfaqësim në 2 seanca gjyqësore shumë prej 270.40 euro (2x135), në emër të ekspertizës mjekësore të ortopedisë 150.00 euro, në emër të ekspertizës së ekspertit mjekësor të psikiatrisë shumë prej 150.00 euro, apo shumë e përgjithshme prej 735.40 euro (shtatëqind e tridhjetë e pesë euro e katër dhjete cent).

Nga të cekurat më lartë dhe bazuar në nenet 136, 137, 140, 159, 169, 174, 179 dhe 183 të LMD-së, lidhur me nenin 323 dhe 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.2070/2022, datë 18.09.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

Udhëzim juridik:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës e Apelit e Kosovës, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.